ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: KOMUNA E FERIZAJT

Për Aktivitetin e Prokurimit : **Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve te Komunes se Ferizajt**

LOT I-Automjetet e DAP-it dhe automjetet e QKMF-së

Nr[1] i prokurimit	**656-24-966-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për : **Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve te Komunes se Ferizajt**

LOT I-Automjetet e DAP-it dhe automjetet e QKMF-së

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

D.P.Z.AUTO-NGJYROSËS ''ECLIPS

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ferizaj

Rr.Hasan Prishtina, 70 000

70 000)

(Kodi postar)

044-446-336
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bekim Elezi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
Dionelezi2002@gmail.com

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa elektronike)

26.04.2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

AUTO NGJYROSJE "ECLIPS" FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate 09.02.2024
Hapja e ofertave: 21.03.2024
Njoftim mbi vendimin e AK : 11.04.2024, ora 08:33
Kerkesa per ri-shqyrtim 16.04.2024

Pergjigje e kerkeses per ri-shqyrtim 17.04.2024 *Kriteri:* Çmimi me i lirë

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	x

Hapja e ofertave eshte bere permes sistemit elektronik e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x			**Jo**	☐

Po jemi njoftuar permes platformes elektronike e-prokurim si OE I PASUKSESSHEM

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK-ja
Neni 1 – Qellimi i ligjit; **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;** **Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi** **Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi**

Neni 60 – Kriteret e dhenies

Neni 69 – Kapaciteti teknik dhe/ose profesional

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve te Komunes se Ferizajt , LOT I-Automjetet e DAP-it dhe automjetet e QKMF-së, nr.prokurimit : 656-24-966-2-1-1.**

Komuna e Ferizaj **si Autoritet Kontraktues me vetëdije të plot ka shkelur dispozitat ligjore te prokurimit publik duke bere shkelje flagrante vetem e vetem per te shperblyer me kontrate nje OE I cili nuk i ploteson kriteret e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.**

Duke u bazuar ne njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit, pra ne ate se qka eshte kerkuar dhe qka eshte derezuar nga ana e OE te rekomanduar , poe paraqesim me poshte kriterin e kerkuar te DT-së :

Kerkesa e AK ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate lidhur me stafin e punes ka qene :

Lista e stafit te bashkangjitur (2 automekanike, 1 auto elektricist, 1 gomister, 1 mbushes i klimes)	OE te paraqet listen e stafit te nenshkruar dhe vulosur min.5 punetorë. Te bashkangjiten
	kontratat ose parakontratat e punetoreve

Pretendimi i pare ankimor.

OE I rekomanduar per kontrate, Ka derzuar listen e stafit qe kane qene kriteret e dosjes se tenderit mirepo nese bejme analizimin e kontratave te punes rezulton qe nuk jane ne perputhshmeri me listen e stafit, pra detyrat e tyre te punes nuk jane sipas listes qe ka prezentuar OE .

Shih listen e stafit qe ka prezentuar OE I rekomanduar

Lista e puntoreve (stafit) "Dashnimi" shpk			
Nr	Emri	Pozita	Dega-profesioni
1	Shaqir Sejdiu	Mjeshter	Automekanike
2	Dashnim sejdiu	Mjeshter	Gomister
3	Muhamet Sejdiu	Mjeshter	Auto elektricist
4	Besim Halili	Mjeshter	Auto mekanike
5	Fidan Sejdiu	Mjeshter	Mbushes I klimes
6	GanimeteSejdiu	Administrate	Administrat

Dashnimi Shpk

DASHNIMI
SH.P.K.
FERIZAJ-GAÇKË

A) Ne Baze te Listes te stafit z.Shaqir Sejdiu pozita e tije e punes eshte Automekanikë, mirëpo ne kontraten e punes Pozita e ti e punes eshte Menaxher I pergjithshem –Drejtor, pra nuk eshte sipas kriterit te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate, eshte kerkuar Automekanik, OE duhet ta paraqes kontraten e punes te automekanikut, ne rastin konkret qka pronari I kompanise z.Shaqir Sejdiu ka nenshkruar kontraten me vet-veten (ne cilesinë e punedhenesit dhe ne cilesinë e punemarresit)

Shihe kontraten e punes (Fleten e pare ku shihet pozita e tij dhe pjesa e fundit, pjesa e nenshkrimit)

KONTRATË PUNE
PËR KOHË TË PA CAKTUAR

Neni 1

Me këtë kontratë, "DASHNIMI" SH.P.K. me seli: GAÇKË - FERIZAJ, me NRF: 810111609 dhe NRB: 810111609 që e përfaqëson SHAQIR SEJDIU (në tekstin në vijim: Punëdhënësi), lidh kontratë pune me SHAIQIR SEJDIU, me numër personal 1003518414, me banim në GAÇKË, FERIZAJ, që posedon kualifikimin MESEM, në tekstin në vijim i Punësuari.

Neni 2

I Punësuari caktohet në vendin e punës: MENAHXHER I PËGJITHSHEM - DREJTORË.
Përshkrimi i detyrave të punës: MENAXHER.

Neni 3

I punësuari do t'i kryejë punët në subjektin afarist "DASHNIMI" SH.P.K. me seli: GAÇKË - FERIZAJ

Neni 4

I Punësuari themelon marrëdhënie pune në kohë të PA caktuar, duke filluar nga data 11.04.2018.

Neni 5

I punësuari është i detyruar të fillojë punën, më 11.04.2018.
Në rast se i punësuari nuk e fillon punën ditën e caktuar sipas kësaj kontrate të punës, do të konsiderohet se nuk ka themeluar marrëdhënie pune, përveç nëse është penguar të fillojë punën për shkaqe të arsyeshme.

Neni 6

Puna provuese e të punësuarit zgjat deri më: _____. Gjatë periudhës provuese të punës, punëdhënësi dhe i punësuari, mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës, me njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh.

Neni 7

I punësuari themelon marrëdhënie pune me orar të plotë. Orari ditor i punës është 8 orë punë në ditë, ndërsa orari javor i punës është 40 orë.

Neni 8

Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi prej 200 €, e cila paguhet së paku një herë në muaj dhe nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale.

Neni 9

I punësuari ka të drejtë në pagë shtesë në përqindje të pagës bazë:

1) 20% në orët për kujdestari,
2) 30% në orët për punë gjatë natës,
3) 30% në orët për punë jashtë orarit,
4) 50% në orët për punë gjatë ditëve të festave dhe
5) 50% në orët për punë gjatë fundjavës.

Neni 17

Të punësuarit i ndërprehet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi, nëse:

1) Ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative,
2) I punësuari nuk është më i aftë të kryej detyrat e punës,
3) Në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit,
4) Për shkak të mospërmbushjes së knaqëshme të detyrave të punës dhe
5) Për rastet e tjera të cilat janë përcaktuar në Ligjin e punës.

Neni 18

Punëdhënësi obligohet të sigurojë dhe zbatojë mjetet dhe masat e mbrojtjes në punë, sipas legjislacionit në fuqi. I punësuari është i detyruar t'iu përmbahet masave të caktuara të mbrojtjes në punë.

Neni 19

Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 20

Punëdhënësi dhe i punësuari i pranojnë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara me Ligj, me Kontratën kolektive dhe me këtë kontratë.

Neni 21

Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësajë kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e gjykatës komunale.

Neni 22

Secila palë mundet ta shkëpusë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me kontratë kolektive.

Neni 23

Në asnjë rast, dispozitat e kësaj kontrate nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se dispozitat e Ligjit të punës ose të kontratës kolektive, për sa i përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës.

Për të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë kontratë, zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e Ligjit të punës dhe të Kontratës kolektive.

Neni 24

Pas njoftimit me përmbajtjen e kontratës, kjo kontratë u nënshkrua në 2 kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbeten nga 1 kopje.

Nënshkruar më 11.04.2018

PALËT KONTRAKTUESE:

I PUNËSUARI

SHAIQIR SEJDIU

PUNËDHËNËSI

SHAQIR SEJDIU

DAÇHNIMI SH.P.K. FERIZAJ-GAÇKË

B) Ne baze te listes te stafit te prezentuar nga ana e OE te rekomanduar per kontrate te radhitur ne listen e stafit nr 2 z.Dashnim Sejdiu,ku pozita e tij e punes eshte Gomister, mirepo ne kontraten e tij te punes detyra e tij e punes eshte Automekanik dhe Vullkanizer, pra nuk ka perputhshmeri ne mes te listes te stafit dhe kontrates se punes.

Vlen te permendet qe ne dosjen e tenderit eshte e specifikuar shume qartë pozitat te cilat jane kerkuar, pra jane kerkuar ndaras pozitat e punes, ku jane kerkuar 5 punetor me 5 pozita te ndryeshme si:

Dy (2) automekanik, Një (1) automogister, Një (1) Autoelektricist dhe Një (1) Mbushes I Klimes.

OE I rekomanduar ne kete rast ka paraqitur z.Dashnim Sejdiun me 2 (dy) pozita te punes e ky variant nuk eshte specifikuar ne dosjen e tenderit dhe ne kete rastin konkret, komisioni I vleresimit eshte dashur ta anlizoj sipas pozitave te kerkuara dhe eshte dashur qe ta eleminoj nga gara dhe jo te bej shkelje te dispozitave ligjore duke shperblyer me kontrate nje OE te papergjegjshem.

Shihni Kontraten e Punes te z.Dashnim Sejdiu

Datë : 14.06.2023

KONTRATË PUNE

Per kohë të pa caktuar

Neni 1:

Me kete kontrate pune DASHNIMI SHPK me seli ne Gaqkë-Ferizaj me nr te biznesit : 810111609 qe e perfaqeson Shaqir Sejdiu, lidhin kontrate pune me Dashnim Sejdiu mr nr personal : 1241053217 .

Neni 2:

I punesuari do te caktohet ne vendin e punes : Automekanik dhe vullkanizer .

Neni 3:

I punesuari do te kryej punen ne subjektin e afaristit DASHNIMI SHPK .

Neni 4:

Pushimi dhe te drejtat tjera i takojn sipas ligjeve ne fuqi te Kosoves.

Neni 5:

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te kontrates.

Punëdhënësi

DASHNIMI SHPK

DASHNIMI SH.P.K. FERIZAJ-GAÇKË

Punëmarrësi

Dashnim Sejdiu

C) Ne baze te listes te stafit te prezentuar nga ana e OE te rekomanduar per kontrate ne stafin e tij radhitur numer 3 (tre) eshte z. Muhamet Sejdiu dhe pozita e tij e sipas (sipas listes te stafit) eshte Autoelektricist, mirepo ne para-kontraten e tij te punes Pozita e tij e punes eshte Autoelektricist dhe Vullkanizer, pra ashtu edhe siç e kemi specifikuar me larte , nje variant I tille i pozitave te punes nuk eshte lejuar nga ana e AK, ashtu siq eshte kerkuar ashtu edhe duhet te jete, eshte kerkuar elektricist duhet te jete elektricist, eshte kerkur vullkanizer pozita e tij e punes dhe roli I tij ne kompani duhet te jete ne vullkanizer, ashtu siç eshte kerkuar pra duhet te kete perputhsmeri te plote me kerkesat e AK.

Shihni Para-kontraten e punes te z.Muhamet Sejdiu

Datë : 14.11.2023

Parakontratë pune

Neni 1:

Me kete parakontrate pune DASHNIMI SHPK me seli ne Gaçkë-Ferizaj me nr te biznesit : 810111609 qe e perfaqeson Shaqir Sejdiu, lidhin kontrate pune me Muhamet Sejdiu me nr personal : 1003118246 .

Neni 2:

I punesuari do te caktohet ne vendin e punes : Autoelektricist dhe mbushes klime .

Neni 3:

I punesuari do te kryej punen ne subjektin e afaristit DASHNIMI SHPK .

Neni 4:

I punesuari themelon marredhenie pune ne rast te shperblimit me kontrate.

Neni 5:

Pushimi dhe te drejtat tjera sipas ligjit te punes do te kryhen pasi te behet kontrate e rregullte.

Neni 6:

Parakontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te kontrates.

Punëdhënësi

DASHNIMI SHPK

DASHNIMI SH.P.K. FERIZAJ-GAÇKË

Punëmarrësi

Muhamet Sejdiu

D) Ne baze te listes te stafit te prezentuar nga OE I rekomanduar per kontrate, punetori numer katër (4) I radhitur ne listen e stafit eshte z.Besim Halili, dhe pozita e tij e punes (sipas listes te stafit) eshte Automekanik, mirepo nje gje e till nuk eshte e specifikuar ne kontraten e tij te punes ku ne kontraten e tij te punes Vendi i punes eshte specifikuar "Punetor'',

Shihe kontraten e punes te z.Besim Halili

Në bazë të nenit 10, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2 dhe nenit 11 të ligjit të punës 03/L-212, i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, me datë 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies Juridike të punës, lidhin këtë:

KONTRATË PUNE
PËR KOHË TË PA CAKTUAR

Neni 1

Me këtë kontratë, "DASHNIMI" SH.P.K. me seli: GAÇKË - FERIZAJ, me NRF: 810111609 dhe NRB: 810111609 që e përfaqëson SHAQIR SEJDIU (në tekstin në vijim: Punëdhënësi), lidh kontratë pune me BESIM HALILI, me numër personal 1003513307, me banim në GAÇKË, FERIZAJ, që posedon kualifikimin MESEM, në tekstin në vijim i Punësuari.

Neni 2

I Punësuari caktohet në vendin e punës: PUNËTOR.
Përshkrimi i detyrave të punës: 0.

Neni 3

I punësuari do t'i kryejë punët në subjektin afarist "DASHNIMI" SH.P.K. me seli: GAÇKË - FERIZAJ

Neni 4

I Punësuari themelon marrëdhënie pune në kohë të PA caktuar, duke filluar nga data 01.08.2018.

Neni 5

I punësuari është i detyruar të fillojë punën, më 01.08.2018.
Në rast se i punësuari nuk e fillon punën ditën e caktuar sipas kësaj kontrate të punës, do të konsiderohet se nuk ka themeluar marrëdhënie pune, përveç nëse është penguar të fillojë punën për shkaqe të arsyeshme.

E) Ne baze te listes te stafit te prezentuar nga OE i rekomanduar per kontrate, edhe punetori numer pesë (5) i radhitur ne listen e stafit i cili eshte z.Fidan Sejdiu, dhe pozita e tij e punes (sipas listes te stafit) eshte Mbushes i Klimës,mirepo ne kontraten e tij te punes pozita e tije e punes eshte Servisim i klimave dhe autovullkanizer.

Shih para-kontraten e z.Fidan Sejdiu

Datë : 14.11.2023

Parakontratë pune

Neni 1:

Me kete parakontrate pune DASHNIMI SHPK me seli ne Gaqkë-Ferizaj me nr te biznesit : 810111609 qe e perfaqeson Shaqir Sejdiu, lidhin kontrate pune me Fidan Sejdiu me nr personal : 1500186654 .

Neni 2:

I punesuari do te caktohet ne vendin e punes : Servisim I klimave dhe auto vullkanizer .

Neni 3:

I punesuari do te kryej punen ne subjektin e afaristit DASHNIMI SHPK .

Neni 4:

I punesuari themelon marredhenie pune ne rast te shperblimit me kontrate.

Neni 5:

Pushimi dhe te drejtat tjera sipas ligjit te punes do te kryhen pasi te behet kontrate e rregullte.

Neni 6:

Parakontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te kontrates.

Punëdhënësi

DASHNIMI SHPK

DASHNIMI

Punëmarrësi

Fidan Sejdiu

Duke u bazuar ne elaborimin tone vijme ne perfundim qe OE nuk e ploteson kriteret e dosjen se tenderit ngase per nje punetor ka caktuar njekohesisht dy (funksione) te punes dhe meqense ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate nga ana e AK nuk eshte lejuar varitantet, nuk eshte specifikuar qe Operatoret Ekonomik lidhur me stafin e punes mund te ndaj punetoret me role te ndryeshme nje gje e till nuk eshte lejuar ,meqense nuk eshte lejuar nga ana e Autoritetit Kontraktues ateher duhet te respektohen kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Pavarsisht kualifiikimeve te tyre, kualifikimet apo Çertifikatat e punetoreve nuk kane qene kerkese e dosjen se tenderit dhe njoftimit per kontrate, jane kerkuar stafi dhe kontratat e tyre ose para-kontratat, OE ka sjellur listen e stafit dhe kontratat e punes, ne baze te tyre shohim qe ka mosperputhsmeri dhe automatikisht eshte dashur te eleminohet nga gara, sepse vlersimi I ofertave behet gjithmone duke u bazuar ne kerkesat e dosjen se tenderit dhe ate se qka kane ofruar operatoret ekonomik.

Meqense edhe po te deshironte AK qe te kerkonte nga OE ti nderroj kontratat e punes te tyre,padyshim qe nje gje e tille nuk eshte e lejuar ne baze te ligjit te prokurimit publik(lista e stafit dhe kontratat e tyre te punes nuk nderrohen) mos te ishin prezentuar PO, mirepo perderisa jane prezentuar atehet mbesin ashtu.

<u>Pretendimi i dytë ankimor</u>

Ne si OE, gjatë qasjes qe kemi pasur ne dokumentet e OE ofertues, si tek OE NTSH."BEKA" (Bekim Haziri B.i.) i cili ne baze te procesverbalit te hapjes se ofertave eshte radhitur i dyti me çmime, AK edhe kete OE e ka radhitur si te Pasuksesshem.

AK-Komuna Ferizaj, OE BEKA e ka kategorizuar si OE te pasuksesshem, mirepo realisht eshte dashur edhe ky OE te eleminohet nga gara, sepse tek stafi i tij i punes, edhe ky OE ne kontratat e stafit te tij ka paraqitur nje punetor me dy pozita te punes njekohesisht, dhe meqenese nje gje e tille nuk eshte lejuar pra nuk ka qene nje variant I dosjes qe OE ofertues mund te ofroj nje punetor me shume role, por ka qene e precizuar pozita e punes, psh.automekanik, autoelektricist etj, atehere edhe ky OE nuk e ka plotesuar kriterin e FDT-së dhe NJK-së, sepse ne kontratat e tij nje punetor ka dy pozita te punes e kjo nuk eshte konform kritereve te dosjes, pra mungon punetori i cili merret eskluzivisht me detyren

e punes "Mbushes i Klimes", ashtu edhe siq eshte kerkuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontraten.

OE ka prezentuar ne stafin e tij te punes z.Leutrim Haziri , ku ne baze te listes te stafit pozita e tij e punes eshte autogomister - Autoklima, pra meqenese nje gje e tille nje variant i till nuk eshte lejuar ne dosjen e tenderit, OE nuk e ploteson kete kriter.

Shih kontraten e punes se bashkangjitur ne dosje te punetorit z.Leutrim Haziri

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE
PËR
KOHË TË CAKTUAR / TË PACAKTUAR

Neni 1

Me këtë Kontratë **N.T.SH."Auto Beka"-, Kllokot-Viti me Nrf; 600160999 ,**
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson: **Bekim Haziri** (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi), lidhë kontratë pune me: **Leotrim Haziri-1176422803, Sh. Mesme , Kllokot -Viti.**
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, numri personal, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit (në tekstin e mëtejshëm: I punësuari).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës:**AutoGomister dhe Serviser i Klimave , Bën rregullimin e automjeteve dhe pune të tjera që urdhëron punëdhënsi.**
(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës)

<u>Pretendimi i tretë ankimor</u>

Gjate qasjes ne dokumenta dhe gjate analizimit te pershkrimi i çmimeve te OE te rekomandaur per kontrate OE."Dashnimi" Shpk dhe te OE i radhitur si i pasuksesshem N.t.sh.Beka (Bekim Haziri B.I.) verejme se te dy keta operator ekonomik kane çmime jo-nornalisht te uleta.

Duke analizuar cmimet e tyre qe kane ofruar keta nuk kane asnje lloj logjike qe kontrata te implementohet me keto çmime pot e krahasohen me cmime te tregut e shohim se nuk qendrojne te verteta por jane cmime sa per te dal me te lire me ofertat e tyre.

Pra, AK edhe ne kete qeshtje eshte dashur te fokusohet dhe ti kerkoj sqarime edhe ne kete pike dhe AK eshte dashur qe t'i eleminoj nga gara sepse cmimet e ofruara nga OE qofte DASHNIMI, poashtu

edhe AUTO BEKA, kane cmime jonormalisht te uleta e qe duhet te trajtohen sipas nenit 61 te LPP-se.

Andaj, AK ka qene dasht te zbatoj nenin 61 te LPP-se, qe ti kerkohen sqarime OE-ve, ne rast se I plotesojne kriteret e kerkuara apo jo te veproj me tutje sipas dispozitave ligjore..

Pergjegjesi e AK-se eshte te kerkoj sqarime sipas nenit 61 te LPP-se, konkretisht sipas paragrafit 2 te ketij neni.

Autoriteti si organ kompetent per vleresimin e ketyre cmimeve duhet te bej nje analize te te gjitha cmimeve te OE-ve te permendur me larte dhe te veproj sipas LPP-se.

Kerkojme nga OSHP, konkretisht eksperti qe ti analizon pretendimet tona ankimore dhe te krahasohen-vlerohen ofertat sipas nenit 59 te LPP-se dhe te zbatohet dispozitat ligjore per Çmime jo normalisht te uleta sipas nenit 61 te LPP-se.

ANDAJ, permes kesaj ankese ne si OE ankues deklarojme se te **gjitha faktet e paraqitura ne kete Ankesë jane te qendrueshme, dhe OSHP ti merr si te bazuara gjate shqyrtimit te pretendimeve ankimore.**

Bazuar ne te gjitha provat e bashkangjitura me larte, kerkojme nga OSHP si organ kompetent per trajtimin e ankesave që të merret :

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e **DPZ AUTONGJYROSES ECLIPS**

II. **OBLIGOHET AK Anuloj Njoftimin mbi vendimin e AK te dates 16.04.2024 dhe Lenda te kthehet ne RI-VLERSIM ,**

III. **Gjate fazes se RIVLERESIMIT, te REKOMANDOHEMI NE per kontrate sepse jemi i vetmi Operator Ekonomik qe i plotesojme kriteret e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri me tani shpenzimet per pergatitjen e ofertes,shpenzimet per paraqitjen e kerkeses per ri-shqyrtim dhe pergaditjen e ankeses ne organin shqyrtues te prokurimit eshte 2,500.00 € Duke llogaritur vleren e deponimit te ankeses, vleren e pergaditjes te dorezimit te ofertes,vleren e pergaditjes se kerkeses per ri-shqyrtim dhe vleren e pergaditjes se ankeses.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*